

## **PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Shërbime**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Shërbim mirëmbajtje, rirretëzim dhe sistem kamera”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Sistemi video-mbikqyrjes, 32323500-8, Shërbime për mirëmbajtjen e sistemit 50324100-3.**

**Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 24.992.000 (njetzet e kater milion e nenteqind e nentedhjete e dy mije) Leke, pa TVSH.**

**Vlera e fondit limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise është 264.549,59 (dyqind e gjashtedhjete e kater mije e peseqind e dyzet e nente presje pesedhjete e nente) Euro**

*\* Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 14.05.2026 është 95.47 Lekë/Euro.*

**Argumentimi:** Perlllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021, të ndryshuar

**Arsyetimi pse procedura nuk mund te ndahet ne lote:**

**Bazuar në nenin 39 të LPP-së dhe në nenin 42 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.**

**Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të shërbimeve, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar.**

**Kjo procedurë shërbimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik i cili do të shpallet fitues, pasi lloji i shërbimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që ky shërbim ka.**

**Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi të gjithë zërat e kërkuar për ofrimin e shërbimit janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte crregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të shërbimit si dhe kosto shtesë për AK.**

**AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës** sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*- Sipas kritereve të përgjithshme shtojca 9*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilance të tre viteve të fundit 2023,2024 dhe 2025 të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e germës “c” të nenit 41 te Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

*Shenim: Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.2.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues për 3 (tre) vitet e fundit 2023,2024 dhe 2025, të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros mesatare e këtyre tre viteve të jetë me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros mesatare, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

*Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 43, VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore të të ardhurave.

**2.2.3.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2026 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

*\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, AK gjykon se kriteri i vendosur lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kërkesave pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **40% të vlerës** së së fondit të limit të përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Shërbime të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

### **Ose**

- b. Shërbime të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

### **Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën oferten të kualifikueshme.**

### **Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:**

- A. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara
  - B. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së shërbimeve, ku të cilësohen shërbimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumenti: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuaranë të shkuarën.”.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për zbatim të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”, me kategoritë si më poshtë:

**Kategoria NS-13 D** Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni

**Kategoria NS-14 D** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera apo Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t’i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s`kualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit Nr.162/2020 “PërProkurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;..Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme** njerëzore e **teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Neni 41/4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet

kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

**Kategoria NS-13 D** Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni është kerkuar pasi Sistemet e kamerave (CCTV) përfshijnë elementë që lidhen drejtpërdrejt me fushën e telekomunikacionit dhe transmetimit të të dhënave. Kamerat IP dhe DVR/NVR transmetojnë të dhëna video përmes **rrjeteve të komunikimit (LAN/WAN)**. Instalimi kërkon:

-Kabllim struktural (UTP, fibra optike)

-Pajisje rrjeti (switch, router)

-Integrim me sisteme monitorimi në distancë

**Kategoria NS-14 D – Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV**, është kerkuar pasi “Objekti i procedurës përfshin furnizimin dhe instalimin e një sistemi kamerash (CCTV), i cili kërkon realizimin e instalimeve të brendshme elektrike dhe të rrjeteve të komunikimit brenda objektit. Sistemi përfshin kabllim të brendshëm, furnizim me energji, pajisje monitorimi dhe transmetim sinjali video. Për këtë arsye, kërkesa për kategorinë NS-14 D – Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV është e nevojshme dhe në përputhje me natyrën e punimeve.”

I. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontrates, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë** të cilët të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Elektrik

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjate gjithë kohës së zbatimit të kontratës, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

*\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a ,2 dhe 4 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;..Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme** njerëzore e **teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Neni 41/4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.;

*Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave. stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin rigoroz të shërbimeve.*

**II. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:**

- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 3 (tre) inxhinier Informatike/Teknologji-Informacion/Elektronik

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjate gjithë kohës se zbatimit të kontratës, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

*\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”*

Neni 41/4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.;

- III. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën 30 (tridhjetë) punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit , duke marrë si referencë datën e shpalljes së njoftimit të kontratës, me profesione si më poshtë:

*Të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar si menaxher projekti në fushën e menaxhimit të projekteve*

*Të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar për ITIL Foundation ose të ngjashëm;*

*Të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar për Sistemet e Operimit Windows MSCA;*

*Të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar si administrator Databaze;*

*Të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar për Sigurnë e Rrjeteve në nivelin Profesional;*

*Të paktën 3 (tre) punonjes te certifikuar nga prodhuesi per videowall dhe dekodera & video storage*

*Të paktën 2 (dy) punonjes te certifikuar nga prodhuesi per programin qendror te manaxhimit*

*Të paktën 2 (dy) punonjes te certifikuar nga prodhuesi per video storage*

*Të paktën 4 (kater) punonjes te certifikuar nga prodhuesi per kamerat me energji diellore*

*Të paktën 4 (kater) punonjes te certifikuar nga prodhuesi per NVR 4G*

*Të paktën 2 (dy) punonjes te certifikuar Elektricist*

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës dhe diplomë/certifikatë përkatëse.

*\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së*

*afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

*Argumentimi Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Neni 41/4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”;*

*Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, sidhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësiaprofesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**”*

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (ne rast se është inxhinier), dëshmi / çertifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, punonjësit si më poshtë:

- a) 1 (një) punonjes të çertifikuar me dëshmi trajnimi si “Specialist per sigurimin teknik dhe shëndetin ne pune” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për

sigurinë në kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) ”Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

- b) 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

***Shenim:** Për specialistin “Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Operatori Ekonomik mund ta disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi për realizimin e objektivit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.*

- c) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër.

*\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 692 datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” (i ndryshuar me VKM-në nr.742, datë 06.11.2003), operatorët ekonomikë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme, duhet të disponojnë si pjesë të stafit ose të nënshkruajë kontratë shërbimi me një mjek të përgjithshëm.

**Person i pajisur me certifikatë për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë** shërben pasi: Siguron zbatimin e legjisllacionit në fuqi për sigurinë në punë. Ul rrezikun e aksidenteve dhe incidenteve në vendin e punës. Mbron jetën dhe shëndetin e punonjësve dhe palëve të treta.

Është kërkuar **Ekspert Zjarrfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Ky ekspert është i domosdoshëm për të evituar ndodhjen e cdo situatë të paparashikuar si dhe mbrojtjen nga zjarri.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 692 datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” (i ndryshuar me VKM-në Nr.742, datë 06.11.2003), grupi për hartimin e kritereve vlerëson se operatorët ekonomikë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme, duhet të disponojnë si pjesë të stafit ose të nënshkruajë kontratëshërbimi me **një mjek** të përgjithshëm.

#### **2.3.4 Certifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomike:**

Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të cilësisë (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).

Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të mjedisit (ISO 14001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme)

Çertifikate konformiteti për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001:2013 ose ekuivalente (e vlefshme)

Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë (ISO 45001:2018) ose ekuivalente (e vlefshme).

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punës që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

**Argumentimi** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor,për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

**-Certifikatë ISO 9001 - 2015** “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mire të cilësisë.

**-Certifikatë ISO 14001-2015** “Për sistemin e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent, kërkohet pasi angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi, kurse metoda më efikase për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistem menaxhimi për mjedisin konform me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO 14001. Kërkesa lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 është bërë, pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kontrates.

**-Certifikatë ISO 45001-2018** “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë” ose ekuivalent, ose certifikatë përditësuar **Certifikatë ISO 45001-2023**, mundëson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj.

### **ISO/IEC 27001:2013 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit**

E nevojshme për mbrojtjen e dokumentacionit teknik, projektit dhe të dhënave të klientëve dhe përdoruesve, duke siguruar integritetin dhe konfidencialitetin e informacionit gjatë gjithë ciklit të punimeve. kërkesa për certifikatën **ISO/IEC 27001:2013** është e domosdoshme sepse garanton që operatori ka **sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit**, i cili siguron **konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë** e dokumentacionit; Parandalon **aksesin e paautorizuar ose humbjen e të dhënave teknike**, që janë thelbësore për realizimin e projektit.

**2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë** Autorizim të Prodhuesit ose distributori i autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të permbajë të dhena të plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të kontratës. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorezojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

AK gjykon se kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.**

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit jane të hartuara nga Grupi i Punës, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Shënim: Në çdo rast kur në specifikimet teknike mund të jetë e përdorur si referenece emri i ndonje marke apo emri te veçante, patente, vizatim ose tip ose origjine ose prodhim specifik, përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.*